

AGRON DURO**REFLEKSE TË THELBIT TË KONCEPTIT GJUHËSOR
TË SOSYRIT NË TERMINOLOGJI**

Një nga idetë më themelore të Sosyrit mbi gjuhën, siç është ajo e karakterit sistemor e strukturor të saj në suazën e shenjës, e huazuar prej tij nga shkencat e përpikta e të zbatuara dhe e futur në studimin pothuajse të çdo rrafshi të gjuhës, u bë tërheqëse edhe për studiues që mëtuan të shqyrtonin shtresa më specifike të leksikut e, në mënyrë të veçantë, leksikun terminologjik. I pari që veçoi një fushë të leksikut, në të cilën mund të zbatohet plotësisht koncepti i Sosyrit mbi gjuhën “ si sistem shenjash për të shprehur idetë dhe si sistem i mbyllur në vetvete “,¹ ishte dijetari austriak, Eugjen Vyster. Vysteri i argumentoi dhe i konkretizoi mendimet e veta në mënyrë të hollësishme në veprën e mbrojtur si temë doktorate në vitin 1931 “ Standardizimi ndërkombëtar në teknikë “².

Është interesante të përmendet me këtë rast se, sikurse Sosyri, ashtu edhe Vysteri patën kundërshtarë dhe përkrahës të shumtë. Megjithatë, ndërmjet Sosyrit dhe Vysterit kishte një dallim thelbësor që lidhej me profesionet e ndryshme, të cilave ata u përkisnin, por edhe me mënyrën se si u pritën dhe u interpretuan idetë e tyre. Vështruar nga kjo pikëpamje, Sosyri ishte gjuhëtar i njohur dhe teorinë e tij të re përkrahësit e mbështetën me entuziazëm, kurse kundërshtarët e kaluan në heshtje. Përkundrazi, Vysteri nuk ishte gjuhëtar, por studiues i një fushe tjetër, inxhinier elektrik, kështu që gjuhëtarët e kundërshtuan, meqë një pjesë nuk e kuptuan, kuse pjesa tjetër nuk donin ta kuptonin. Nga ana tjetër, specialistët jogjuhëtarë e pritën teorinë e Vysterit me miratim të plotë, por heshtën, sepse nuk ishin në gjendje t’i argumentonin idetë që ato përmbanin.

Si specialist i një fushe teknike, Vysteri, me intuitën e një njeriu që zotëronte disa gjuhë të huaja dhe në mënyrë të veçantë gjuhën e shkencës e të teknikës, e kuptoi se koncepti i Sosyrit mbi karakterin shenjor të

¹ F. de Sosyr, *Kurs i gjuhësisë se përgjithshme*, Tiranë, 2002, f. 42-44.

² E. Wüster, *Internationale Sprachnormung in Der Technik*, VDI, Berlin, 1931.

gjuhës dhe mundësia e trajtimit sistemor të saj, më shumë se kudo tjetër janë plotësisht të zbatueshme në terminologji. Duke e konsideruar termin si të lidhur më ngushtësisht e më drejtpërdrejt me konceptin dhe objektin, në krahasim me fjalën (= fjalën e zakonshme), Vysteri e vuri termin në pozicion ndërmjet fjalës si shenjë gjuhësore dhe simboleve e shenjave të tjera jogjuhësore. Duke e afruar termin më shumë me simbolin se sa me fjalën, ai e veçoi terminologjinë si një fushë studimi ndërdisiplinore, të vendosur në kufi më logjikën, me psikologjinë dhe me vetë gjuhësinë. Sigurisht kjo ide shkaktoi reagime edhe më të forta nga kundërshtarët e tij gjuhëtarë. Kjo shkëputje që i bëri Vysteri terminologjisë nga leksiku i gjuhës si një sistem të mëvetësuar shërbente vetëm për ta ngritur atë në nivelin e një shkence më vete me objektin e saj specifik. Për studimin e kësaj shkence ai hodhi bazat e teorisë së përgjithshme të saj, ndërtoi parimet e studimit dhe metodat e analizës së dukurive si edhe të njësive që e përbënin atë.

Duke mos u kufizuar në interpretimin teorik të konceptimit të vet, Vysteri iu fut punës, në bashkëpunim me shumë specialistë të fushës së mekanikës, për konkretizimin praktik të ideve të tij, duke hartuar “Fjalorin e termave të makinave përpunuese”³, me përkufizime, në anglishte dhe në frëngjishte. Ky fjalor shërbeu si model i përpunimit me baza të shëndosha e të vërteta shkencore të terminologjisë edhe për hartimin e fjalorëve shkencorë sistematikë dhe me përkufizime. Edhe në ditët e sotme, ndonëse për përpunimin e terminologjive të fushave të ndryshme të dijes zbatohen teknika të sofistikuara (kurse Vysteri e ndërtoi Fjalorin e vet me metoda klasike), fjalori i tij shërbeu, sikurse shërben edhe në kohën e sotme, si model i mirëfilltë për përpunimin dhe standardizimin e terminologjive në rrafsh kombëtar e ndërkombëtar.

Idetë e Vysterit, qysh para Luftës së Dytë Botërore, u përhapën në shumë vende të Europës. Në mënyrë të veçantë në ish-Bashkimin Sovjetik jehonë të veçantë atij i bëri D. Lotte. Por Lotte, sikurse Vysteri, nuk ishte gjuhëtar, por specialist i fushës teknike dhe si i tillë nuk u mirëprit nga gjuhëtarët. Megjithatë edhe ai, duke përshtatur për terminologjinë, sikurse edhe Vysteri, idenë e sistemit u bë themelues i shkollës sovjetike të terminologjisë. Vepra e tij “Bazat e ndërtimit të

³ E. Wüster, *Machine Tool: Dictionary of Basic Concepts*, London, 1968.

terminologjisë”⁴ shërbeu për përpunimin mbi baza shkencore të terminologjive të shumë fushave të dijes. Megjithatë, vlen të theksohet, se edhe shkollat terminologjike që u kristalizuan më vonë, si shkolla çeke, ajo sovjetike etj., kishin edhe veçoritë e tyre sidomos në disa konceptime të teorisë së terminologjisë, por në praktikën e punës, në metodat e studimit të lëndës nuk kishin dallime. Kështu, shkolla sovjetike nuk i përmbahej plotësisht teorisë së Vysterit mbi mëvetësimin e plotë të terminologjisë nga leksiku i përgjithshëm dhe studimet bëheshin në lidhje të ngushta me leksikun e përgjithshëm (përmendim këtu Kandelaki⁵, Danilenko); dukuri të tilla semantike, si sinonimia, polisemia, homonimia shiheshin afërsisht të pranueshme edhe në terminologji..

Vysteri la një trashëgimi të pasur shkencore nga fusha e terminologjisë. Ai botoi një varg punimesh shkencore, udhëzues për përpunimin e terminologjisë dhe për standardizimin e saj në rrafsh kombëtar e ndërkombëtar.⁶ Përveç kësaj, me nismën e vet ai ndërmoi një kurs leksionesh mbi terminologjinë “ *Hyrje në teorinë përgjithshme të terminologjisë* “, duke e përfshirë terminologjinë si lëndë mësimore në Departamentin e Gjuhësisë së Përgjithshme dhe të Zbatuar në Universitetin e Vjenës (qysh nga viti 1972). Pas vdekjes së Vysterit terminologë të vendeve të ndryshme të Europës vijuan e thelluan më tej punën e tij me një varg veprash themelore mbi probleme të kësaj fushe me karakter të përgjithshëm e të veçantë, si Felber (Austri)⁷, Sager (Hollandë)⁸, Piht (Danimarkë)⁹ etj.

Shkolla terminologjike e Vjenës e themeluar prej Vysterit u bë qendër për krijimin e një vargu organizmash për bashkërendimin e veprimtarive në fushë të terminologjisë në mbarë botën. Si më të rëndësishme mund të përmendim Qendrën Ndërkombëtare të

⁴ D. Lotte, “Osnovi postroenjia naučno-tehniçeskoj terminologjii”, Moskva, 1961.

⁵ T. Kandelaki, “Problemi jazika, nauki i tehnikii”, *Znaçenja terminov i sistemi znaçenij naučno-tehniçeskih terminov*, Moskva, 1970.

⁶ Shih: E. Wüster, “Das Worten der Welt”, *Sprachforum* 3 (1959/60), no. 3/4, f. 183-204. Për vepra të tjera themelore Shih: H. Felber, *Terminology Manual*, Paris, 1984.

⁷ H. Felber, *Terminology Manual*, Paris, 1984.

⁸ J. Sager, *A Practical Course in Terminology Processing*, Amsterdam, 1990.

⁹ H. Piht, *Terminology: An Introduction*, Denmark, 1985.

Informacionit të Terminologjisë (Infoterm) pranë Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit në Vjenë. Prej Infotermi udhëhiqet dhe bashkërendohet puna në fushë të teorisë e të praktikës terminologjike në botë, botohen udhëzues, fjalorë model, ndërmerren veprimtari ndërkombëtare, zhvillohen kurse specializimi për terminologjinë. Kështu, p.sh., para disa vitesh (në 1989), dy punonjës shkencorë nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (H. Pasho, V. Dervishi, sektori i terminologjisë), ndoqën në Infoterm një kurs specializimi për këtë fushë.

Reflektimet patën idetë e Vysterit edhe në terminologjinë shqiptare, sidomos mendimet e tij rreth karakterit sistemor të terminologjisë, rreth përparësisë së konceptit para termit, rreth barasvlerësisë term-koncept etj. Këto ide janë pasqyruar edhe në punime të ndryshme shkencore për terminologjinë¹⁰, madje edhe në ndonjë vepër të veçantë¹¹, si edhe në hartimin e ndonjë fjalori terminologjik.¹²

Teoria e Sosyrit për leksikun e gjuhës së përgjithshme dhe teoria e Vysterit për leksikun terminologjik janë si dy rrathë që ndërpriten njëri me tjetrin, por njëri, rrethi i teorisë së Sosyrit është më i madh, kurse, ai i Vysterit, është më i vogël (ose shumë i vogël). Ndonëse në bazë të studimit të leksikut, si për Sosyrin ashtu edhe për Vysterin, është trajtimi sistemor, Sosyri vë në bazë sistemin e kuptimeve (të vlerave gjuhësore) që dalin nga marrëdhëniet brenda shenjës, të shënuesit me të shënuarin, kurse Vysteri në bazë të trajtimit sistemor të leksikut terminologjik vë konceptin si pikënisje për përpunimin e terminologjisë, për identifikimin e termit etj. Kjo bën që të krijohet një kundërvënie në nivelin shenjor të leksikut të mbarë gjuhës dhe leksiku të ndahet në dy pjesë pak a shumë të mëvetësuar në fjalë (ose fjalë të zakonshme) dhe në terma (=në joterma dhe në terma). Në bazë të kësaj ndarjeje pak a shumë të prerë të këtyre dy shtresimeve të njësisë leksikore përlligjet edhe ndarja e gjuhës në dy pjesë, gjuha e përgjithshme dhe gjuha speciale (ose gjuha për qëllime speciale)¹³. Kjo tezë ndonëse sot është e pranueshme nga terminologët

¹⁰ V. Dervishi, "Termet e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor", *Studime filologjike*, 1991/1.

¹¹ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.

¹² *Fjalor i termave themelore të bujqësisë* (grup autorësh), (me përkufizime e me rend sistematik e alfabetik), Tiranë, 2006.

¹³ Shih për këtë më me hollësi: 1. H. Piht, *Terminology: An Introduction*, Copenhagen, 1985; 2. A. Duro, "Terminologjia në ligjërimin e specialzuar", *Studime filologjike*, 1997/1-4.

dhe specialistët e lëndës që merren me veprimtari terminologjike (si Galinski, Piht, Felber), nuk është plotësisht e pranueshme prej gjuhëtarëve, të cilët e shohin këtë vijëndarje si të papërligjur. Megjithatë kjo ndarje duhet pranuar, sidomos kur kufizohemi në mënyrë të veçantë në praktikën terminologjike, pra, në praktikën e punës terminologjike, në rezultatet që merren, kur terminologjia shihet si e shkëputur nga leksiku i gjuhës së përgjithshme si sistem i një fushe të vetme të dijes. Kjo jep mundësi që fusha të shihet si më e sistemueshme dhe më e strukturueshme dhe të përdoren më lehtë në të metodat e shkencave të zbatuara. Kjo rrethanë nuk mohon nga ana tjetër mundësinë për ta parë terminologjinë dhe në kuadrin e leksikut të mbarë gjuhës dhe në lidhje me leksikun e përgjithshëm, pra, jashtë sistemit terminologjik, ku termi, jashtë fushës së vet, fiton vetitë e fjalës së zakonshme dhe shfaqet plotësisht në të njëjtat dukuri si në gjuhën e përgjithshme, si polisemia, sinonimia etj.

Mbështetur në modelin dypjesësh të shenjës gjuhësore të Sosyrit, Vysteri modifikoi (përshtati) për terminologjinë modelin katërpjesësh të termit, të cilin e shtjelloi me hollësi në punimin “Fjalësimi i botës”¹⁴. Meqë ky problem nuk është objekt në këtë parashtrësë, këtu do të përmendim vetëm se në modelin katërpjesësh të termit Vysteri futi objektin individual – konceptin individual – konceptin abstrakt dhe shenjën gjuhësore (Si shembull ai sjell marrëdhëniet ndërmjet “Tokë”-”Saturn” (si objekte, koncepte individuale dhe “satelit” (si koncept i ndërtuar mbi bazën e dy koncepteve individuale) dhe të shenjës *satelit*, si shënues të këtij koncepti).

Duke vënë në bazë të krijimit të terminologjisë sistemin dhe konceptin, Vysteri e ngriti gjithë ndërtesën terminologjike të çdo fushe dije dhe të leksikut terminologjik në përgjithësi pikërisht mbi këto dy baza, si shtylla themelore mbështetëse. Në këtë mënyrë sistemi brenda çdo fushe dije krijohet në bazë të marrëdhënieve logjike ndërmjet koncepteve (marrëdhënieve gjini-lloj): *automjet-automobil-veturë*), si edhe të marrëdhënieve ontologjike (të tërës dhe pjesës etj. si: *sy - kokërdhok - bebe*) dhe të një vargu marrëdhëniesh funksionale. Pra, mund të krijohet një paralelizëm ndërmjet lidhjeve të krijuara ndërmjet shenjave gjuhësore (fjalëve) në bazë të kuptimeve (të përbashkëta ose të afërta) në gjuhën e përgjithshme dhe të lidhjeve të krijuara ndërmjet

¹⁴ E. Vüster, Shih: 6.

shenjave gjuhësore (termave) në bazë të marrëdhënieve të vendosura ndërmjet koncepteve në terminologji. Në këtë kuptim gjen shprehje të plotë konceptimi i sistemit sipas Sosyrit, se “ jashtë ligjëratës, fjalët që kanë diçka të përbashkët shoqërohen në kujtesë dhe kështu formohen grupe në gji të të cilave mbretërojnë raporte shumë të ndryshme “. ¹⁵ Për t’i bërë këto marrëdhënie sa më konkrete dhe të kapshme nga makina (kompjuteri) Vysteri krijoi një simbolikë të tërë si dhe futi në studimin dhe në përpunimin e terminologjive si edhe në hartimin e fjalorëve përkatës metodat grafo-analitike dhe statistikore, të cilat dhanë mundësi për ndërtimin e bankave terminologjike dhe futjen e informatizimit në terminologji. Në këtë mënyrë Vysteri e afroi dhe e lidhi terminologjinë me shkencat e tjera si me logjikën, me teorinë e informacionit, me informatikën dhe bëri të mundshme zbatimin e metodave të tyre në fushën e terminologjisë.

Konceptin e sistemit dhe të strukturës të Sosyrit Vysteri e futi në mënyrë integruese në terminologji dhe kjo shërbeu për t’i parë marrëdhëniet ndërkonceptore jo vetëm në lidhjet e jashtme ndërmjet termave, por edhe në përmbajtjet e brendshme të tyre (në intensionet dhe ekstensionet), çka pasqyrohej në sistemimin e përkufizimeve, standardizimin e terminologjisë nëpërmjet mënjanimin të dukurive të sinonimisë, të polisemisë etj. Kjo jepte mundësi për identifikimin e termave dhe ndërtimin e sistemeve terminologjike homogjene e të qëndrueshme, duke u mbështetur jo mbi termin si njësi të veçuar, por përmes atyre vlerave tërësore që ia jep atij gjithë ai sistem marrëdhëniesh, në të cilat termi hyn dhe që kushtëzojnë ekzistencën e tij si element i një të tërë ¹⁶.

Megjithatë, siç e përmendëm edhe më sipër, teoria e Vysterit i ngjan një rrethi që, ndonëse ndërpritet me teorinë e Sosyrit, është nga njëra anë, shumë më i vogël se rrethi i Sosyrit, kurse, nga ana tjetër, është i përfshirë në të. Kjo do të thotë se teoria e Vysterit ka vlerë të plotë, kur,

¹⁵ Shih: 1, f. 142.

¹⁶ Ky konceptim i terminologjisë është pranuar dhe prej terminologëve tanë, të cilët e kanë zbatuar atë në përshtatje me leksikon terminologjik të shqipës. Kështu, p.sh., në doracakun “Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore “ F. Leka thekson; “Termet paraqiten për diskutim jo sipas rendit alfabetik, por sipas një ndarjeje sistematike, duke u nisur nga fusha sa më të ngushta e sipas lidhjeve që ekzistojnë ndërmjet nocioneve”, Tiranë, 1983, f. 44.

në çdo rast, kemi të bëjmë me terminologjinë e një fushe të caktuar të dijes, ku termi shihet si element i atij sistemi. Brenda këtij sistemi mënjanohehen (ose të paktën minimizohen, duke u pranuar si të dëmshme) dukuritë e sinonimisë, të polisemisë, të homonimisë, sepse këtu, në këtë rast, kemi të bëjmë më marrëdhënie të ndërkëmbyeshme një koncept-një term dhe një term-një koncept). Jashtë tij këto dukuri shfaqen afërsisht njësoj dhe si e tillë terminologjia futet në rrethin e madh të Sosyrit. Ky kalim i jep, sipas rastit, herë Sosyrit, herë Vysterit të drejtë dhe gjithnjë vlerësimi i njërit apo i tjetrit bëhet duke u nisur nga fakti se për cilën pjesë të leksikut bëhet fjalë.

